



MSG

MINUTES

31 TETOR 2016

ORA 12:00

MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE

Të pranishmit

Anëtarë të MSG

Z. Dritan Spahiu, MEI

Znj. Borjana Shaka, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve

Z. Bilal Koçi, SHGJSH

Z. Përparim Alikaj, FIAA

Z. Sami Neza, ShC

Z. Ilir Aliaj, ShC

Z. Dritan Dervishaj, Antea Cement

Z. Oltion Kuke, Drejtorja e Përg. ë Doganave

Znj. Entela Muha, Ministria e Drejtësisë

Z. Sokol Mati, Beralba Sh.a

Të tjerë

Znj. Dorina Çinari, Albania EITI

Znj. Emanuela Zaimi

Z. Agim Shehu, Albania EITI

Znj. Anisa Deda Albania EITI

Z. Lluka Gjergo, Albania EITI

Znj. Rudina Konçi, Albania EITI

Znj. Arlinda Rumbullaku, Albania EITI

Znj. Emiliana Kola, Albania EITI

Znj. Eni Bajraktari Albania EITI

Znj. Çinari: Përshëndetje të gjithëve! Dua t'ju informoj që kemi marrë njoftim zyrtar, Shqipëria do ta filloj procesin e Validimit në 1 prill 2017. Do të kemi një aktivitet të ngjeshur përpara, një betejë por besoj se do dalim mirë nisur nga krahasimi me vendet e tjera. Ky është njoftimi i parë. Do të na vijë edhe zyrtarisht me shkresë. Aktivitet shumë i rëndësishëm që pritet të finalizohet deri në janar 2017 është ndërtimi i “roadmap” përpara i përket publikimit të pronarëve të vërtet. E kemi folur edhe në trajnimin që kemi bërë me BB edhe në diskutimet në MSG që kemi pasur më përpara në muajin korrik, është një nga ato çështjet e xehta që po merr vlerë shumë në raportimet në EITI. Të gjitha vendet njëkohësisht, duhet që në 1 janar 2017 të publikojnë listën e aktiviteteve që ato parashikojnë të nevojshme në mënyrë që deri në vitin 2020 të mund të realizohet, si nga ana ligjore dhe nga ana praktike publikimi i Beneficial Ownership ose i pronarëve të vërtet. Kjo do jetë një punë shumë e madhe nga Ministria e Drejtësisë besoj. Ne jemi në procesin e një rishikimi ligjor, do bëjmë një skanim të kuadrit aktual ligjor. Jemi duke parë 12 ligje, VKM, akte ligjore etj. në mënyrë që të shohim se çfarë kemi aktualisht. Kemi disa gjëra aktualisht por do na duhet ta rishikojmë në mënyrë të atillë që të ndihmojmë nismën tonë. Dmth, kush qëndron vërtet pas një aktiviteti, përveç atyre që janë pronarët zyrtarë që shpallen në QKL, kush ka interesa mbrapa atij biznesi, kjo është ideja e nismës.

Z. Alikaj: Vetëm për kompanitë private se ato publike janë të qarta.

Znj. Çinari: Për kompanitë private. Kompanitë publike i kanë të listuara të gjitha.

Z. Mati: Po kompanitë private, a ja kanë dhënë të dhënat QKR-së?

Znj. Çinari: Nuk ka rëndësi, ajo mund të jetë ashtu por mund të jetë që jo. Dmth mund të jetë që pronari është Dorina Çinari dhe mbas meje qëndron një person me angazhim politik. Dhe këto gjëra ndodhin, jo vetëm në Shqipëri por gjithë andej dhe ky është qëllimi nismës. Kjo nuk do bëhet vetëm në Shqipëri por do bëhet në 50 shtete paralele, e para dhe e dyta të gjitha kompanive do ti kërkohet të deklarojnë në mënyrë vullnetare siç bëjmë deklarimin në ILDKP, siç bëjmë deklarimin për anti korrupsion. Do ti kërkohet të deklarojnë, natyrisht pasi të bëhen rregullimet e nevojshme ligjore, kush janë pronarët përfitues dhe ka një formular që përcakton, jep përcaktimet, jep thresholdet, kush është sasia e interesit që mban një x person në atë kompani dhe ato duhet të deklarojnë në mënyrë vullnetare. Nga ai moment më pas fillojnë disa mekanizma

të tjerë verifikues që përcaktohen me ligj dhe që nuk mund ta themi dot sot se kush do jenë por kemi kohë, kemi katër vite kohë deri sa të arrijmë te pika që neve do jemi në gjëndje ti deklarojmë këto. Dhe thashë, nuk është vetëm Shqipëria por janë 50 vënde EITI që do të ecin paralel me këtë nisëm. Aktualisht janë vetëm UK edhe Ukraina që kanë miratuar kuadrin ligjor për pronarët e vërtet, kanë ndërtuar regjistrin online ku të publikohen të dhëna dhe kanë filluar edhe raportimet e para. Pra kjo është gjëndja sot për sot që flasim. Ne në Sekretariat kemi ndërtuar një listë aktivitetesh që mendojmë që janë të nevojshme për të arritur te objektivi final. Do ta ndajmë me të gjithë, do ta shikoni dhe do bëni komente e juaja dhe do mbiledhi pas një muaji për të thënë ne kemi këto propozime, këto janë ok, këto nuk janë ok, ne mendojmë të shtojmë këto gjëra, apo skemi marrë parasysh gjëra që janë të rëndësishme. Do kemi shumë nevojë për komentet e juaja, do të kemi shumë nevojë për komentete e Ministrisë së Financave që nuk është këtu, Ministria e Ekonomisë, QKL, dmth do jetë një nismë shumë më e madhe sesa është EITI tani.

Z. Neza: Formulari është unik i deklaramit të pronësisë?

Znj. Çinari: Ky është një formular template që është ndërtuar nga EITI. Ky formular mund të realizohet 100% si ai por mund të ketë karaktere shtesë që i vendosim ne si Shqipëri, mund të ketë karaktere mangut që vendosim neve ti heqim sepse ashtu e shohim specifikën tonë.

Z. Neza: Ju e keni ndërkohë këtë formular?

Znj. Çinari: Formulari është publikuar që në shkurt. Është miratuar në Lima ku keni qënë edhe ju dhe është që në shkurt publik por natyrisht që mund ta ndaj me juve. Kjo është pak a shumë stadi i diskutimeve deri tani dhe mbasi të mbledhim komentet e juaja do publikojmë draftin e parë të aktiviteteve. Kush do jetë lista e atyre aktiviteteve që do mundësojnë publikimin e beneficial owners. Do shohim edhe planet e vendeve të tjera, do mësojmë edhe nga vendet e tjera, do shohim dhe do bëjmë. Nuk e di a keni ndonjë pyetje, e kuptoj që për të gjithë ju është pak e papërcaktuar...?

Z. Mati: Ju normalisht zyrtare do merrni të dhënat që janë në QKR, që janë të përcaktuara, se mund të thuash përshëmbull që 10% të kësaj i ka x, megjithëse janë në emrin tim, kush është ai që do ta thotë këtë?

Znj. Çinari: Ky është qëllimi po kjo nuk do ndodhi sot, do përgatitet terreni dalë ngadalë.

Z. Mati: Se unë nuk mund të them që unë marr 10000 lekë dhe 5000 lekë ja jap X dhe 5000 lekë i mbaj për vete. Nëse është e deklaruar që unë kam 10% të aksioneve, pronar i 10 % quhem unë.

Znj. Çinari: Jo jo, aksione që nuk qëndrojnë fasad por edhe thjesht, duhet të shohim definicionet përshembull se kush quhet Beneficial Owner. Ka disa definicione që ne edhe mund ti rekomandojmë për Shqipërinë edhe mund ti shtojmë sipas kontekstit.

Z. Mati: Ne tani flasim kot, duhet të shikojmë ndonjë urdhër. Se ai formulari template se kush janë aksionerët do ja japësh QKR-së dhe mbaron.

Znj. Çinari: Jo vetëm kush është aksioner por kush ka aftësi për të marrë vendime, kush vendos në kompani edhe pse nuk e ka emrin?

Z. Alikaj: Është e vështirë kjo...

Znj. Çinari: Po e di që është e vështirë. Nuk do ndodhi brenda ditës, do jetë në matric zhvillimi i informacionit dmth do kemi Shqipërinë, UK, Amerikën, Gjermaninë, Lituaninë, Armeninë do ndodhi paralel dhe do mësojmë nga njëri tjetri.

Z. Mati: Dorina llogjika është pak...T`ju them unë juve, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka një Drejtor të Përgjithshëm ka edhe një Bord drejtorësh që marrin vendimin, tani të themi ne që se merr Drejtori dhe bordi vendimin por e merr Ministri?

Znj. Çinari: Është e vërtet ky është fokusi?

Z. Mati: Po është e ngatërruar kjo punë...

Znj. Çinari: Është shumë e ngatërruar nuk do ndodhi sot do kemi katër vite dhe në 2020 kërkohet, është marr vendimi në Lima në Bord dhe kanë vendosur që edhe Shqipëria të jetë palë.

Z. Alikaj: Do bëhet një lloj vetingu edhe këtu.

Z. Mati: Kjo nuk ka as një të keqe por më duket pak e ngatërruar.

Znj. Çinari: Nëse ne do fillojmë procesin e negociatave për në BE ne do jemi të detyruar të bëjmë harmonizimin ose përafrimin e ligjeve. Një nga ligjet është direktiva e katërt kundër pastrimit të parave dhe korrupsionin. Direktiva e katërt kundër pastrimit të parave dhe korrupsionin është kjo që po flasim, ndoshta EITI ka shtuar disa karaktere por direktiva e katërt e BE për anti money laundry dhe korrupsionin është fiks zbulimi i pronarëve të vërtet dhe nëse neve do fillojmë të kemi negociata me BE do jemi të detyruar të bëjmë përafrimin e ligjit se ndryshe, duam sduam ne do na çoj aty si të gjithë.

Z. Mati: EITI filloi me vetëdeklarimin në kuptimin që të marri vesh publiku. Kur vjen puna që ti kërkon, kjo është pjesë e prokurorisë ta quash me logjik ose ILDKP tamam reale, që ti merr paratë që ka marr Sokoli dhe Sokoli ku i ka gjetur paratë.

Znj. Çinari: Ne e dini që kemi një ligj, se edhe unë tani e kam mësuar ndërkohë që po bëjmë këtë skanimin që kemi një ligj për parandalimin e pastrimit të parave dhe në këtë ligj shkruhet; pronarët përfitues konsiderohet dhe ka katër parashikime një që ka 25% aksione, një që ka 25% aksione të fshehta, një që ka 25% të drejtë vendimarrje, i keni të shkruara në ligj por kjo është tjetër për transaksionet financiare.

Z. Mati: Unë them si do ta zgjidhësh praktikisht se po flasim për një raportim ligjor se nëse unë shkruaj aty po themi kot Beralba X 50 %, mbaroi filmi.

Znj. Çinari: Ju jeni okay ashtu siç jeni. Ka kompani të tjera që kanë tjetër pamje.

Z. Neza: Njësoj si deklaratat e vetdeklarimit të pasurisë. Kështu ka qënë në fillim kur u bë deklarimi i pasurive kishte skepticizëm, si do bëhej. Shumë e thjesht deklaroi, deklarata bëhet publike.

Z. Mati: Po normale publike janë por duhet gjetur edhe pak mekanizmi se nuk mund ta bësh ti me llogjikën që Sokoli të thotë që i ka marrë 10 dhe 5 ja ka dhënë Bilalit. Kush është ai Sokol që e thotë këtë.

Z. Neza: Në përgjithësi janë gjetur.

Z. Mati: EITI kthehet në një funksion tjetër, pjesë hetimi.

Znj. Shaka: Do ta delegoj, do ta konstatoj EITI dhe nuk besoj që do marri veprim, thjesht konstaton.

Znj. Çinari: Jo nuk është EITI kompetent, thjesht zbulon, deklaron.

Z. Neza: Do bëhen transparente ato që deklarohen dhe shoqëria civile merret me grupin investigues.

Z. Aliaj: Deri më sot është gjetur vetëm një rast që ka të bëjë me paratë e Alijevit, Presidentit të Azerbajxhanit dhe ai gazetari që i ka zbuluar paratë është detyruar që të largohet nga vendi . Por ky është i vetmi rast dhe në rastet e tjera janë të gjitha dyshime.

Z. Neza: Edhe Kryeministri i Islandës.

Z. Aliaj: Doli te Panama Papers jo se u gjet nga EITI...

....

Z. Aliaj: Meraku i Sokolit është që EITI po zgjerohet shumë dhe po merr një rol që se ka. Megjithatë kjo çështja e këtyre Sokol e kemi biseduar që herët këtë histori dmth dhe unë kam qënë një nga iniciatorët që vjet- parvjet më duket, e kam ngritur disa herë me rradhë këtë histori. Është shumë e vështirë sepse janë shumë;, Panama, Vergian Islands që janë...

Z. Mati: Parajsa fiskale ke me qindra.

Z. Aliaj: Që nuk ke ku ti gjesh por unë besoj që nuk është edhe krejt e pamundur dmth, po pate vullnet edhe i gjen. Kjo është ajo që thua ti që zgjerohemi dhe marrim rolin e prokurorisë.

Z. Mati: EITI u nis fillimisht me vetëdeklarim. Unë marrë pjesë thjesht se dua të jem pjesë e kësaj nisme për të qënë unë si kompani e qartë me publikun ku punoj dhe kryesisht llogjika e EITI-t kur u ndërtua, u ndërtua me llogjikën që ti do fillosh punë në Bulqizë dhe populli i Bulqizës ku ti punon të kuptoj që ti mos më lufto mua se unë i kam derdhur shtetit 1 milion \$ taksa. Dhe këto 1 milion \$ duhet të vinë sipas ligjit 20% e tyre, ti i ke marrë këto 20 % apo jo? Që njerëzit ta dinë, ta marrin vesh që 200000 \$ nga taksat e mia duhet të venë te bashkia. Kjo ishte llogjika e fillimit edhe e kompanive që tentuan të hynë. Tani nëse fillohet që kompania duhet të deklaroj këtë, atë, EITI del jashtë gjithë kësaj gjëje në kuptimin edhe ligjor.

Znj. Çinari: Caqet i kanë përcaktuar “stakeholders” nuk ti ka përcaktuar vetëm EITI.

Z.Mati: Dorina edhe formulari që është vënë në VKM i cili nuk ka ndryshuar akoma, nëse edhe këta që e bëjnë, Deloitte shtojnë një tabelë të re, këto duhet të bëhen ligjore sepse unë e kam më të thjeshtë. Ne tani të gjithë e njohim Jonidën dhe i themi po hajde shtoje formularin, bëje por është një punë që më shtohet mua si administratë. Tani mua më duhet të lë një njeri të bëjë edhe këtë tabel edhe atë tabelë.

Znj. Çinari: Gjithësesi nuk është ky fokusi i komunikimit, që mos humbasim kohë.

Z. Mati: Dorina kot po e hapim, unë e mbyll.

Znj. Çinari: Mos të dalim nga tema.

Z. Mati: Ta bëjmë ligjore atë që bëjmë. Në ligjin minenar e ke të shkruar duhet të deklaroj EITI, me ligjin e naftës që duhet të deklarojë EITI dhe atëhere me çdo ndryshim që bëhet edhe nga EITI Ndërkombëtar duhet ti reflektojmë në këtë legjislacion.

Znj. Çinari: Pikërisht atë thashë.

Z. Mati: Sepse VKM-ja është akoma VKM e 2011.

Znj. Çinari: VKM-ja ka lidhje me raportimin financiar, ne po flasim për një iniciativë tjetër që po kalon në një skanim ligjor. Do nxjerri disa produkte, disa rekomandime, ndoshta dhe një VKM, ndoshta një ligj dhe këtë do ta shohim rrugës. Sot që po flasim kemi nisur vetëm procesin e skanimit ligjor.

Z. Mati: Unë po them për këtë që është bërë deri tani. Formulari që është në VKM është komplet ndryshe nga ky tani.

Znj. Çinari: Unë e kam diskutuar këtë që thoni ju me ekspertët ligjor dhe po të lexosh formulimin në ligjin minenar dhe në ligjin për hidrokarburet thuhet: “Kompanitë janë të detyruara të raportojnë në kuadër të standartit EITI, në përputhje me standartin EITI”. Standarti EITI ndërron çdo 6 muaj, kjo nuk do të thotë që ti çdo 6 muaj të bësh rishikime ligjore. Kur thua në përputhje me Standartit EITI automatikisht përkthehet që siç është standarti EITI sot ashtu do

raportosh ti sot dhe ky është nga ana ligjore interpretimi. Unë nuk jam juriste dhe nëse ma kanë thënë gabim...

Z. Mati: Në logjik; nuk është ashtu, unë nuk jam dakort me këtë.

Znj. Çinari: Juristët i shkruajnë ligjet.

Z. Mati: Nuk është ashtu se nëse thua standarti EITI me update-imet përkatëse dhe do të thotë që VKM-ja duhet të ndërrohen, ndryshon tabela, ndryshon template. Ndryshojnë 5 pika dhe template-i ndryshon sipas këtyre 5 pikave. Vitin që vjen ndryshon pjesa e personave që duhet të jenë pjesë përshembull dhe është normale që do shtohet se VKM-ja këtë pasqyron. Unë këtë ligj kam dhe nesër të dorëzoj atë tabelën fikse në shtet dhe nuk kam asnjë detyrim ligjor. Është gjë tjetër vetdeklarimi, unë deklaroj se nuk kam asgjë të fsheh por që ta ketë kjo të lehtë edhe ti ta kesh të lehtë do të thotë ta kesh detyrim ligjor që ai të raportoj sipas këtij standarti.

Znj. Çinari: Sokol më fal që mos ta humbas fokusin e takimit. MSG-ja në mbledhjen e radhës do ftoj në tavolin dy punonjës që punojnë në drejtorinë ligjore që janë marr me këtë shkrim dhe kanë përparësi dhe le ta diskutojmë me eksperta. Unë nuk jam eksperte, më kanë thënë nëse shkruhet kështu kjo do të thotë që në çdo ngjyrë që do marri standarti je i detyruar të aplikosh standartin pa pasur nevojë të bësh VKM çdo 6 muaj. Ky është opinini ligjor.

Z. Aliaj: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë thotë që çdo konventë, çdo pjesëmarrje e Shqipërisë në konventa, institucione ndërkombëtare siç është rasti i EITI-t duhet përkthyer dhe ligjëruar në shqip. Pra ne nuk mund të njohim standartin e EITI në anglisht. Ne këtu mund ta njohim por ai tjetri që është në Bulqizë nuk e kupton prandaj duhet ligjëruar në shqip.

Znj. Çinari: E kemi në shqip.

Z. Aliaj: Por duhet bërë urdhëresë, rregullore, vendim.

Z. Mati: Duhet të kesh parasysh që në 2011 nuk dihej seç që EITI. Në 2009 kam qënë në Washington për të firmosur EITI-n dhe kur kam ardhur këtu nuk më kanë kuptuar vetë Ministrat. Sot këta që bëjnë një vendim duan një urdhër të vaçant dhe për një pikë të ligjit. Pata një muhabet me këtë para një kohe dhe thotë nuk është shkruar udhëri, po pse qamet i madh është të shkruhet një urdhër. Në 6 muaj ndryshon kjo, në 6 muaj e bën edhe template-in e ri. Ti e kupton

sa veta ka firma në Bulqizë, është pronari dhe ka dhe një ekonomist, kaq. Tani ai duhet të dërgoj raportin tek ky, tek AKBN-ja, te Ministria, etj., i vete edhe ti EITI dhe thotë ai ik, kurse kur është e shkruar ligjore është urdhër. Dhe je i detyrur siç do ta dërgosh raportin tek AKBN-ja e dërgon edhe tek Sekretariati.

Z. Aliaj: Sokol më fal që të ndërpres, mund të bëhet edhe më thjesht. Në bazë të legjislacionit tone, EITI ka hyrë në Shqipëri kështu ne mund të marrim edhe një vendim këtu. Mund të bëhet një përkthim i një direktive që jep EITI.

Znj. Çinari: S'japin direktiva ato, është vullnetar thonë.

Z. Aliaj: Vullnetar ok, direktivë, rekomandim, si të duash mund ta quajmë dhe ne e përkthejmë këtu dhe e bëjmë në MSG, të bëhet vendim për zbatim sepse në ligjin minerar, në ligjin për hidrokarburet ai është vendosur nga parlamenti që na jep ne të drejtë .

Znj. Çinari: Të kërkojmë raportim.

Z. Aliaj: Që të bëjmë ndryshim në se nuk do merret Ministri, Kryeministri, Parlamenti për të bërë një shkresë.

Z. Ziu: Formatet me VKM nuk janë praktike. Ty përderisa të është thënë sa herë që ndryshon ajo duhet aplikuar varianti i fundit ajo ta ka krijuar hapësirën.

Znj. Çinari: Sokoli thotë kompania ska pse të pyesë ty se nuk e ka urdhëresë.

Z. Aliaj: Atë thashë nëse është në ligj, në ligjin minerar dhe në ligjin për hidrokarburet kompania do përgjigjet patjetër.

Znj. Çinari: Po janë në ligj.

Z. Aliaj: Po ndryshimet pra, template, një urdhëresë.

Znj. Çinari: Ju e Ministrisë së Drejtësisë keni ndonjë mendim?

Znj. Muha: Nuk jam juriste jam inxhinierë me profesion.

Znj. Çinari: Dakort!

Z. Mati: Ti pyet çfarë stresesh heq Jonida.

Znj. Çinari: Nuk kanë thënë asnjëherë që nuk është kërkesë ligjore, kanë pasur arsye të tjera apo jo?

Znj. Vesiu: Po.

Znj. Çinari: Është ngritur ndonjëherë pretendimi që nuk e kanë pasur kërkesë ligjore, përveç kompanive hidroenergjitike që ato po nuk e kanë?

Znj. Vesiu: Kompanitë e hidroenergjiave e kanë ngritur si problem ndërsa bizneset minerare jo.

Z. Ziu: Ideja është, forma mund të jetë një faqe por mund të jetë edhe 50 faqe. Për atë është ndryshe të plotësoj një faqe dhe ndryshe të plotësoj 50 faqe kështuqë debati mund të lindë te kompanitë në këtë aspekt. Ajo formë që do të plotësohet, unë them që është jo praktike se kam punë me Këshillin e Ministrave edhe për gjëra të tjera. Është jo praktike që për një gjë që rinovohet shpesh, në çdo 6 muaj, sidomos në nivelin e formës. Se është tjetër gjë nëse Këshilli i Ministrave duhet të vendosë ndonjë gjë a duhet të jemi anëtar apo sduhet të jemi anëtar që është gjë pak më madhore por tek forma hapësira me sa kuptoj nga ligji është krijuar tani duhet gjetur një mënyrë që kjo formë.

Z. Mati: Të ketë mundësi të update-ohet.

Z. Aliaj: Na e jep mundësinë ligji. Ne mund ta bëjmë këtu nuk ka nevojë ti themi Ministrit.

Z. Mati: Ilir nuk po them unë që kemi kufizim ligjor, unë them që ta thjeshtojmë punën që të jenë subjektet e qarta çfarë do shkruajnë

Z. Aliaj: Shumë dakort!

Z. Mati: Qoftë me një urdhër.

Znj. Çinari: Letra zyrtare që shkon nga Ministria e Energjisë ku i kërkon kompanive të raportojnë në kuadër të standartit sipas formularëve bashkangjitur quhet? Sepse çdo operatori para se të filloj raportimi i shkon një letër zyrtare.

Z. Aliaj: Po është e mbyllur atëhere. Unë nuk e dija që ka letër zyrtare nga Ministria.

Znj. Çinari: Ditën që fillon raportimi i shkon një letër zyrtare, i nderuar operator në kuadër të këtij ligji, nr. kaq..., jeni të detyruar të raportoni në këtë format dhe formularët bashkangjitur.

Z. Mati: Quhet kjo normale. Tani që mos ja dërgosh të tëra kompanive, ti atë formën e nxjerr me një urdhër e vë në internet dhe mbyllet.

Z. Aliaj: Nëse dërgohet letra kjo është e mbyllur.

Z. Mati: Mos të lodhen këto të dërgojnë letra.

Znj. Çinari: Ne nuk lodhemi sepse ne njoftojmë fillimin e raportimit të ri me atë letër. Filloi raportimi i EITI për vitin 2015. Jeni përzgjedhur të jeni pjesë e këtij raportimi. Në referencë të ligjit x, standartit, të këtij vendimi, jeni të detyruar të raportoni dhe formularët bashkangjitur. Afati është ky, personat përgjegjës këta. Edhe vit për vit ke edhe një situatë të re dhe e shkruan.

Z. Aliaj: Që ta mbyllim si procedurë ligjore thotë Sokoli që ndonjëri mos thotë gjë duhet hedhur edhe në internet.

Znj. Çinari: Në internet janë me firmë por janë.

Z. Mati: Në katër vjet është ndëruar 4 herë, shtohet kjo-ajo. Këto janë ndryshime se vërtet thamë që kompanitë do marrin pjesë do vetëdeklarojnë por kur vjen puna një kompani që është me një person në administratë, ka një milion qyfyre që i ngelin tatimet nga mëngjesi dhe nuk ka nerva ai të merret me EITI-n e Dorinës.

Znj. Çinari: E vërtet është ajo Sokol por ja që kështu është procesi.

Z. Mati: Në këtë sens e kisha.

Znj. Çinari: Edhe VKM-ja prapë nuk e thjeshton atë faktin që ka një punonjës dhe një pronar. Proçesin nuk ja thjeshton.

Z. Mati: Proçesin nuk ja thjeshton por ja vendos detyrim ligjor. Ai e merr të detyrueshme.

Znj. Çinari: Ok, ju thashë në takimin që vjen do ftoj në tavolinë drejtorinë ligjore të ministrisë që të na sqaroj mbi këtë gjë, sa e nevojshme është, si duhet ti bëjmë rishikimet, a janë ok apo nuk

janë ok. Edhe flasim me ekspert se unë nuk jam, unë mund të them çdo arsyetim teknik por nuk jam eksperte.

Znj. Mati: Nuk është se e thashë unë dhe është e drejtë.

Znj. Çinari: Meqënëse humbëm kohë. Ok tani të fillojmë me raportimin nga Deloitte, Drafti i parë mbi Rakordimin.

Znj. Vesiu: Po mbi rakordimit, para një jave ne nisëm raportin e parë të rakordimit. Sot kemi printuar një raport të azhornuar. Kemi marrë parasysh edhe raportimet apo korrigjimet që janë kryer gjatë javës nga subjektet edhe nga institucionet. Përsëri diferenca në këtë stad ku jemi mbetet relativisht e lartë dhe larg atyre objektivave që kemi neve nën 1%, është diferenca që po thuajse kemi pasur çdo vit prej gati pesë vitesh. Gjithësesi deri diku një pjesë e diferencave janë në proces sqarimi dhe besojmë që do jetë e menaxhueshme zgjidhja e tyre në një afat një javor ose dy javor. Problem mbeten disa shoqëri që nuk kanë raportuar ende apo që janë pak më të vështira apo pak më të avashta në bashkëpunim. Do ti shohim te pjesa e sektorit minerar dhe të sektorit hidroenergjitik por sigurisht mund të ketë...

Z. Aliaj: Më fal, afërsisht sa mund të shkoj diferenca që mund të bëhen këto pas javës që presim?

Znj. Vesiu: Objektivin e kemi nën 1%.

Z. Aliaj: Sa mund të shkojnë se objektivi është diçka tjetër?

Z. Mati: 99% e ka tani.

Znj. Vesiu: Jo 99 është vetëm për disa pagesa.

Z. Aliaj: Se tha është më e lartë se sa objektivi apo jo?

Znj. Vesiu: Po diferenca në këtë moment në sektorin e naftës është 18 %.

Znj. Çinari: Nga eksperiencia ne na ka ndodhur që deri dy ditë para publikimit të raportit kemi bërë rakordime.

Z. Aliaj: Dakort dakort, përafërsisht sa mund të shkoj?

Znj. Vesiu: Ne e kemi bërë një analizë të diferencës.

Z. Aliaj: Shkon te 1%?

Znj. Vesiu: Po, më pak se 1% ka shkuar çdo vit.

Z. Aliaj: E kam 1% , a pritet edhe këtë vit të shkoj më pak se 1%?

Znj. Vesiu: Ne shpresojmë që po.

Z. Aliaj: Ok dakort.

Znj. Vesiu: Me ato që jemi në proces do ketë një impakt shumë të madh por ka ende subjekte që nuk kanë raportuar, institucione që nuk kanë raportuar por besoj nëse na raportojnë edhe ato brënda një jave mund të na japin kohë ne që në harkun e dy javëve të bëjmë rakordimin dhe sqarimin e të gjithave çështjeve që mund të lindin. Në sektorin minerar, pjesa më e madhe e pagesave janë barazuar në masën 99% pra është mbërritur tek një diferencë nën 1%. Kemi disa raste që ndikojnë japin një impakt të lartë në diferencë dhe këto janë rastet kur kryesisht nuk kemi marrë raportim nga subjekti apo nga tatimet si dhe rasti, ndikimi i Albpetrolit. Albpetroli ende nuk ka raportuar.

Z. Aliaj: Për sektorin minerar?

Znj. Vesiu: Jo unë e kam nisur me sektorin e naftës dhe gazit.

Z. Aliaj: Kalove te sektori minerar.

Znj. Vesiu: Ok në rregull.

Znj. Çinari: Ndoshta ishte shprehja gabim. Cili sektori ishte nën masën 80%?

Znj. Vesiu: Në masën 80% është sektori i naftës dhe gazit. Sektori minerar është në masën 14 % është më pak sigurisht se kemi një institucion që nuk ka raportuar. Kemi Albpetrolin që nuk ka raportuar në sektorin e naftës dhe gazit. Në rastin e dytë kemi shumë subjekte që nuk kanë raportuar.

Znj. Çinari: Sa është lista deri sot?

Znj. Vesiu: Janë 29 subjekte minerare që nuk kanë raportuar për herë të parë. Janë subjekte që janë kontaktuar me forma të ndryshme, me telefon, me email.

Z. Aliaj: Pra jemi minus 18% vetëm për Albpetrolin?

Znj. Vesiu: Ka subjekte që nuk përgjigjen në asnjë lloj forme ka subjekte që pretojnë që do raportojnë.

Z. Spahiu: Të bëj një pyetje te nafta dhe gazi nuk mund të mos ketë raportime?

Znj. Çinari: Albpetroli deri me tani nuk ka raportuar megjithese gojarisht unë kam marrë prentimin e drejtorit që do fillojnë rakordimin.

Z. Spahiu: Doja të bëja një koment, pashë tatim-fitimin për Bankers. Normalisht mund të jetë e drejtë se është vendosur ai njoftimi i vlerësimit tatimor mbas rezultateve të kontrollit të AKBN-së se siç e dimë asnjë nga kompanitë sot nuk paguan tatim fitimin. Mbas kontrollit të AKBN-së u bë një vlerësim i kontrollit tatimor. Kjo çështje është në gjykim dhe nuk është final, AKBN-ja ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të pezulloj njoftimin e vlerësimit tatimor. Ose bëni një koment aty që kjo çështje është në gjykim se duket sikur është paguar tatim fitimi.

Znj. Vesiu: Në fakt edhe subjekti edhe tatimet kanë raportuar të njëjtën shumë, barazojnë në këtë pikë. Është paguar atëhere, duhet të vendoset koment i që është në subjekt gjykimi. Ok, në rregull do ta shënojmë. Nuk është raportuar në këtë formë por nga subjekti është raportuar thjesht pagesë.

Z. Spahiu: Detyrimi ka qënë rreth më i madh rreth 7- 8 milion. Ka vazhduar pagesa me këste dhe në 2016, ky raport është për 2015 apo jo, në 2016 ka vazhduar pagesa deri sa është pezulluar. Për të shmangur keqkuptimet ndaj një personi të tretë që lexon raportin do sygjeroja që të vendosni një koment që kjo çështje është në gjykim.

Znj. Çinari: Kjo duhet shkruar në informacionin kontekstual. Se rakordimi është bërë duhet pjesë e informacionit kontekstual ku duhen shpjegime.

Znj. Vesiu: Mund ta lidhim më tutje me pagesën që është raportuar. Në sektorin minerar kemi 29 subjekte që nuk kanë raportuar. Ne kemi nisur një listë të detajuar me historinë e komunikimit të gjithë secilit. Besoj këtu duhet marrë ndonjë vendim nëse do niset një shkresë e dytë, një komunikim zyrtar.

Znj. Çinari: Natyrisht një komunikim zyrtar të gjithëve, absolutisht.

Znj. Vesiu: Njëri nga subjektet meqë ra fjala tek vështirësitë që kanë në plotësimin e formularit, njëri nga subjektet na nis vazhdimisht bilancin dhe refuzon të plotësoj formularin sepse gjykon që është punë shtesë për të, nuk e shikon të nevojshme.

Znj. Çinari: Është operator i vogël?

Znj. Vesiu: Si operator është relativisht i vogël.

Znj. Çinari: Janë disa kompani me një individ gjithësej.

Znj. Vesiu: Ne do sjellim një analizë prodhim-pagesë edhe të ardhurat në mënyrë që të bëjmë një farë krahasimi sepse përzgjedhja është bërë mbi bazën e prodhimit ndërkohë që sot kemi të dhëna për të ardhura dhe pagesa të plota nga Tatimet dhe Doganat, në këtë mënyrë do të identifikojmë nëse këta vërtet nuk janë në prodhim të madh dhe kanë pagesa të mëdhaja të raportuara për ta plotësuar analizën.

Znj. Çinari: Ok listen e operatorëve që s'kanë raportuar e kemi dhe që sot do ti nisim një komunikim zyrtar të gjithëve.

Znj. Vesiu: Janë 29 këtu.

Znj. Çinari: Çështja është që këta thonë edhe gjobën ma vendosni dhe nuk duan t`ja dinë se na ka ndodhur, na vëni gjobë thonë, nuk duan t`ja dinë.

Znj. Vesiu: Ka raste që nuk duan të marrin telefonata nga ne, na e kanë shprehur hapur. Mos ti shqetësojmë më në telefon!

Znj. Çinari: Ok do komunikojmë edhe me Mehmetin për këta.

Znj. Vesiu: Te sektori i hidroenergjisë situata paraqitet më dobët. Janë mbi 50% e subjekteve pa raportuar, 8 nga 15. Për dy nga këto subjekte premtojnë që do raportojnë, janë vazhdimisht me vonesë. Ndërkohë që dy kanë refuzuar haptazi bashkëpunimin, kërkojnë që ne mos ti kontaktojmë më. Tre subjekte nuk përgjigjen në asnjë nga mjetet e kontaktit.

Znj. Çinari: Si është bërë përzgjedhja e kompanive të hidroenergjisë Lluka?

Znj. Gjergo: Prodhimin që kanë realizuar për 2015, informacioni i dhënë nga AKBN-ja duke filluar nga prodhuesi më i madh.

Znj. Çinari: Të jenë prodhuesit më të mëdhenj dhe të refuzojnë bashkëpunimin me shtetin, se i kuptoj këto të vegjëlit por një prodhues i madh i respekton marrëdhëniet me shtetin?

Znj. Vesiu: Diferenca për sektorin e hidroenergjisë për momentin është 57% ne presim që kjo diferencë të zvogëlohet sepse jemi në diskutim edhe me tatimet. Kemi vënë re disa pagesa që mundet të korigjohen nga ana e tatimeve sepse janë shumë të larta edhe për vetë përmasat që ka biznesi. Hapi i parë ishte ballafaqimi i diferencave me biznesin. Sot kemi marrë një përgjigje nga biznesi dhe po ballafaqojmë diferencat me tatimet kështu që presim që një pjesë e diferencave të zgjidhen sepse edhe në diskutim me biznesin kemi kuptuar që shumat e raportuara janë shumë herë më të larta se sa çmund të jenë të ardhurat e vetë biznesit kështuqë do të ketë një lapsus edhe në raportimin që kemi marrë nga tatimet por që besoj do ta zgjidhim shpejt. Mundet që të lëmë një takim me departamentin e IT-së për të kuptuar se si janë nxjerrë informacionin dhe për të parë nëse ka problematika në vetë raportim.

Z. Ziu: Atyre që s'kanë raportuar dërgojini një shkresë.

Znj. Çinari: Natyrisht të gjithë atyre nga sot do i dërgojmë një shkresë të fort përveç hidroenergjisë që nuk kemi një bazë të gjerë ku ti detyrojmë dhe raportimi për ata është vullnetar dhe vetë raportimi nga ana jonë i hidroenergjisë është vullnetar dhe nuk kërkohet nga standarti por neve e kemi marrë si angazhim dhe duhet ta plotësojmë. Pjesa tjetër, subjekte minenare subjekte hidrokarbure janë të detyruar të raportojnë në të gjitha format. Tjetër?

Znj. Vesiu: Jo .

Znj. Çinari: Nëse nuk ka ndonjë pyetje, nga ana juaj kush është ndihma që doni ju nga kjo tavolinë në këtë proces, ku ka ngecur dhe ku ju duhet ndihma e kësaj MSG-je që thoni ne duam nga ju të bëni këtë gjë? Si mendoni duke, nëse procesi po ecën okay shumë mirë për ne, nëse mendoni që ju duhet ndihmë nga MSG-ja ose nga institucionet...

Znj. Vesiu: Deri sot kemi dy institucione që nuk kanë raportuar Albpetroli dhe ERE dhe Ministria e Finacave që ka pjesën kontekstuale nuk përfshihet në raportim. Pastaj për subjektet ne mendojmë që i kemi ezauruar të gjitha format e komunikimit dhe kemi mbërritur në pikën që nuk shohim më rezultat. Do ishte mirë të kemi një letër të dytë për subjektet.

Znj. Çinari: Ka ndonjë propozim se si mendoni ti drejtohem operatorëve? Është bërë prezantimi me email, kanë qënë qënë të gjithë prezent në sallën e madhe aty, kanë dëgjuar prezantimin, kanë pasur formularin, kanë pasur mundësi të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje, nuk janë bërë shumë pyetje, pak pyetje janë bërë por bënëin sens dhe që nga ai moment...

Znj. Zaimi: “Feedback” nuk është se ka qënë “nuk e kuptoj” por është çështje mospranimi.

Znj. Çinari: Po nuk duan.

Znj. Spahiu: Ka ndonjë manual për plotësimin e formularit?

Znj. Vesiu: Ka instruksione dhe neve jemi si “call center”, jemi vazhdimisht në telefon për ti sqaruar kur na e hapin telefonin.

Znj. Spahiu: Shumë mirë. Unë mendoj që kanë raportuar çdo vit dhe është krijuar ekspertiza e nevojshme.

Znj. Çinari: Raportimi i Albpetrolit është një nga raportimet më të rëndësishme në kuadrin e raportit EITI, dmth ka fokus shumë të veçantë sepse quhen ndërmarrje me pronësi shtetërore që zakonisht janë kështu si njolla të zeza dhe kjo është fokusi shumë i madh se si operon një ndërmarrje e tillë. I ke parë vjet kërkesat se çfarë kërkohej në kuadër të Albpetrolit ka kërkesa të forta. Biles ne kemi pasur kërkesa për të bërë pilotim enkas për Albpetrolin, për shitjet e naftës që marrin.

Z. Spahiu: Për informacionin tuaj Albpetroli sot që flasim prodhon vetëm 45 mijë ton nga 1 milion e 300 ton.

Z. Alikaj: Bëhet fjalë për Ballshin.

Z. Spahiu: Pra është më pak se 10 % e gjithë prodhimit në total.

Znj. Çinari: Më tepër fokusi është te nafta që mbledh në natyrë nga operatorët sipas marrëveshjeve hidrokarbure. Si administrohet, si shitet te operatorët me çfarë procesi, sa transparent dhe këto jemi të detyruar ti raportojmë nëse duam ti mbahemi standartit në të kundërt do të quhet që nuk i jemi përmbajtur standartit, do jetë notë negative.

Z. Spahiu: Pa hyrë në detaje, procedura e shitjes bëhet me Urdhër Ministri është e detajuar, ankandi është publik.

Znj. Çinari: Shumë mirë pra këto gjëra duhet ti kemi në raportim, është shumë më tepër nga çfarë i kërkohet një operatori standart. Albetrolit i kërkohet më tepër.

Znj. Spahiu: Pesha është më pak se 10%.

Znj. Vesiu: Pavarësisht nga pesha, mungesa e raportimit nga ana e Albpetrolit sjell dyshime për shkak të statusit që ai ka.

Znj. Spahiu: Nuk mendoj që ka mangësi, thjesht ngarkesë pune.

Znj. Vesiu: Po po, por nëse ai ka raportuar çdo vit dhe në një raport në një vit mungon është...

Znj. Spahiu: Unë do kontaktoj vetë me ata dhe do ja them.

Znj. Çinari: Tani ka ardhur ku nuk mban më se bëhet shumë e vështirë këtë muajin e fundit raporti EITI, se mbidhet i gjithë informacioni, duhet të dali drafti, drafti duhet vlerësuar, duhen bërë komente duhet publikuar dhe është raporti që na çon në validim. Pra këtu jemi në pikën që në cdo gjë që bëjmë duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Do ti ndjekim rast pas rasti, sot dua se çfarë doni nga ne, çfarë zhurme duhet të bëjmë me institucionet Albpetrol edhe ERE, me Agjencitë Shtetërore dhe me Ministrinë e Financave.

Znj. Vesiu: Ne nuk kemi marrë nga AKBN-ja, Drejtoria e Hidroenergjisë ende raportimin që është për informacionin kontekstual dhe nuk presim të ketë impakt të madh në rakordim, gjithësesi të tre drejtorive të AKBN-së i është kërkuar që të raportojnë edhe tarifatat e arkëtuara

nga subjektet, totali i të ardhurave për tarifatat e shërbimit, kështu që pavarësisht se me impakt të vogël është një raportim që duhet të jetë sipas Termave të Referencës që ka hartuar kjo MSG.

Znj. Çinari: Ok. Keni ndonjë pyetje?

Znj. Zaimi: Përveç këtyre të rejave që nuk ju janë përgjigjur për herë të parë keni ndonjë regres nga operatorët më përpara që nuk janë konsistent dhe nuk e plotësojnë formularët?

Znj. Vesiu: Unë kam parë përmirësim në bashkëpunimin me operatorët që kanë qënë për vite rresht të përfshirë. Ata që nuk raportojnë kanë qënë të vështirë edhe vjet ose janë të rinj.

Znj. Çinari: Ok, kemi ndonjë pyetje për Deloitte? Në këtë fazë është shumë e rëndësishme që të finalizojmë raportin. Shumë faleminderit nga Tatimet, nga Doganat si gjithmonë kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë dhe vërtet e vlerësojmë, na e kanë thjeshtësuar shumë procesin. Ok nuk është shkëlqyer por është shumë më e shkëlqyer se herët e tjera

Znj. Vesiu : Po e vërtet është një përparim i ndjeshëm në kohë edhe në sasi.

Z. Ziu: Tani është edhe e rëndësishme që te letra që do i çohet përveç se të jetë energjik si të thuash por të jenë edhe afatet e shkurtra.

Znj. Çinari: Kush janë afatet që doni ju dhe janë të pranueshme për ju?

Z. Ziu: Para dy javësh.

Znj. Çinari: Atë e dimë, tani nga këtu ku jemi, letrën do ta shkruajmë sot dhe e nisim nesër me gjithë përpjekjet tona. Kush është afati i fundit që ne ta menaxhojmë procesin?

Znj. Vesiu: Ne e kemi draft raportin më 20 nëntor mos gaboj por që të arrijmë draftin në 20 nëntor ne duhet që rakordimin ta kemi mbyllur të paktën pesë ditë para.

Znj. Çinari: Deri më 10 nëntor.

Znj. Vesiu: Deri më 10 nëntor.

Z. Ziu : 7- 8 nëntor ti lini si afat se ne nuk e dime çfarë na pret, se ata do sjellin shifrat por duan punë dhe ti thuhet përveçse do ta nisim në 7, në periudhën nga 7 deri në 15 mos ti mbajnë telefonat mbyllur por të jenë në dispozicion që çdo gjë që është për tu sqaruar të sqarohet.

Znj. Çinari: Ok, do bëjmë letrën dhe do bëjmë përpjekjet tona tani siç do vit, u pa puna.

Z. Ziu: Këtyre të hidroenergjisë ti çohet një letër e veçantë.

Znj. Çinari: Ok, ne do jemi në një shkëmbim të shpeshtë tani bashkë në mënyrë që të kapim afatet.

Jonida: Dhe në pritje nga Ministria e Financës është pjesa e rentës që besoj do ketë goxha fokus.

Znj. Çinari: Kjo do jetë shumë interesante se do jetë hera e parë që shohim se si shpërndahet renta tani tek pushtet lokal.

Znj. Vesiu: Me email ne kemi marrë rentën e shpërndarë tek njësitë e qeverisjes vendore por nuk kemi marrë ende metodën se si është shpërndarë renta, edhe vlerën totale të rentës nuk e kemi marrë.

Znj. Çinari: Nëse ju duhet ndihmë nga ne ju lutem na thoni. Keni ndonjë gjë tjetër për Deloitte që ti lëmë të ikin të punojnë se kanë shumë punë? Tani diskutojmë pak shkurt ose gjatë sa të doni ju për Strategjinë e Komunikimit që duhet të ndjekim në dy muajt që kemi dhe në vitin 2017. Fokusi shumë i madh i nismës EITI është se si e komunikojmë iniciativën, si i komunikojmë gjetjet, si i tërheqim grupet e interesit dhe si i arrijmë të krijojmë një diskutim, një debat publik në mënyrë që të kemi forma, Emanuela Zaimi është zgjedhur si specialistja e komunikimit që ka marrë përsipër detyrën për të bërë një analizë të gjëndjes aktuale dhe kush mund të jenë ato forma që të japin impaktin më të madh sa i përket komunikimit. Ema, shumë shkurt të lutem gjetjet dhe nëse ka pyetje i shtjellojmë. Çfarë mendon ti që është me interes? E dëgjojmë Emën.

Znj. Zaimi: Faleminderit që më keni bërë pjesë të grupit të punës. Në fakt duke ditur se çfarë kam pëgatitur por duke parë edhe diskutimet e bollshme mu bë pak qejfi se kuptova se jam në të njëjtën linjë. Janë shumë gjëra që ndoshta duhet të sqarohen me çdo palë interesi që bën pjesë në këtë. Unë kam menduar këtë fund viti sigurisht dhe të vitit tjetër të komunikimit EITI, pak më të thellë në diskutime dhe pak më të thellë në problematikat, operatori, shoqëria civile do jetë pjesë, median edhe gazetarët si pjesë me të vërtet kryesore që duhet të gjenerojnë më pas atë debatin publik. Pra si një formë të thelluar të të gjithë aktiviteteve që do kemi në 2017, për të kuptuar

akoma dhe më shumë dhe për të bërë një analizë akoma më të thellë. Nga analizat paraprake sigurisht që EITI ka disa vite tashmë ende nuk është i dëgjuar dhe ende nuk është i kuptuar.

Znj. Çinari: Masivisht.

Znj. Zaimi: Edhe masivisht por edhe vetë brënda operatorëve të kuptojnë vlerën. Është pak e vështirë dhe e bëjnë si detyrim ligjor por duhet ta marrin dhe ta kthejnë si një vlerë të shtuar që jemi pjesë e standartit EITI sesa e kemi për detyrë. E kam menduar dmth, ne jemi këtu dhe ndoshta dhe një brez i caktuar e kuptojnë vlerën e burimeve natyrore që është një pasuri kombëtare, por a është brezi i ri brezi që kemi sot vërtet i ndërgjegjshëm, qoftë ai lokal qoftë ai që ka aktivitet të industrisë nxjerrëse pra në gjithë Shqipërinë? A jemi ne ende të vetëdijshëm për këtë pasuri, çfarë na sjell, si investohet, apo njihet vetëm si një pronë e operatorit apo si një pronë ndoshta e vetë shtetit? Kështuqë mendoj që një pjesë të mirë duhet të zinte përsëri ndërgjegjësimi dhe informimi i publikut për atë çka përfaqësojnë burimet natyrore dhe që janë pasuri e jona. Mund të duket ndoshta si primitive, por besoj që është një gjë shumë e nevojshme që duhet të bëjmë. Fushatat publicitare duhet të fokusohen kryesisht tek pjesa e informimit dhe pastaj se çfarë bën EITI. Shikoj pikë kritike marrëdhënien sistematike dhe të rregullt të EITI-t me median, qofshin ato media lokale apo qofshin ato media kombëtare, sidomos në ato zona ku ka aktivitet nxjerrës. Nga ana tjetër e dimë besoj jemi koshient të gjithë që kur vjen puna për një gazetar të mirëfilltë që të bëjnë ekonomi të vërtet, janë shumë të cekët dhe nuk është se kemi gazetarë të mirëinformuar, por ndoshta mund të jetë problem edhe koha e gazetarit sot për tu thelluar në raportin EITI. Megjithatë vetë raporti EITI, unë mendoj, që është voluminoz, paçka që ka dhe një formë të përmbledhur. Pra, mendoj që është detyrë e EITI-t në vazhdimësi krijimi i kësaj marrëdhënie, orientimi i medias dhe trajnimi i tyre si ta lexojnë raportin EITI. Dmth duhet të jenë përveç takimeve zyrtare duhet të kuptojmë që duhet pak kreativitet kur ndërtojmë dhe krijojmë një marrëdhënie me median dhe duke e ndërthurur pak me argëtim ndoshta.

Z. Spahiu: Keni shumë të drejtë kur thoni që raporti është shumë voluminoz dhe kur e shikon në pamje të parë thua çfarë po ndodh. Por nëse për sektorin elektroenergjetik kemi një raport që unë e kam lexuar nga fillimi deri në fund dhe them që është shumë i mirë dhe shumë i detajuar, për sektorin minerar dhe hidrokarbur nuk ka sot që flasim një raport zyrtar të shtetit Shqiptar në gjithë aktivitetin e një niveli të caktuar. Përpara Ministria e Energjisë botonte ato broshurat e famshme deri në 2004, por sot nuk ka absolutisht asnjë raport përveç raporteve që nxjerrin

Bankers, Alpetrol që nxjerr një analizë vjetore por që është vetëm për Albpetrolin dhe raporti EITI plotëson këtë boshllëk dhe është shumë i mirë dhe për promovimin e industrisë. Investitorët mund ta marrin dhe ta përdorin këtë raport.

Znj. Zaimi : Edhe kjo duhet përcjellë dhe ti bëjmë edhe ata që ta kuptojnë këtë. Ndërsa duke qenë se prek edhe investitorët, një nga format e tjera që unë kam propozuar të komunikimit të vazhdueshëm me gjithë palët e interesit duke përfshirë edhe investitorët është edhe që duhet të vimë me një “newsletter” periodik, me një buletin informativ periodik i cili të shpërndahet në institucione sigurisht, me të rehat, edhe shifrat dhe çfarë mund të jetë atraktive për sektorin dhe të shpërndahet ose duhet të gjejmë një mënyrë që ta shpërndajmë jo vetëm nëpërmjet website të EITI-t.

Z. Spahiu: Po si mund të shpërndahet ndryshe?

Znj. Zaimi: EITI e ka një databazë të mirëfilltë të gjithë palëve të interesit. Duhet ta çoj nëpërmjet emailit ose të paktën të jetë mundësia që të jetë “subscribe” që do regjistrohem vetë për ta marrë por si fillim .

Z. Spahiu: E dyta është më e mirë.

Znj. Zaimi: Po por si fillim duhet t’ja komunikosh që ekziston, sepse aty kur të vjen me email për herë të parë ai mund të zgjedhi edhe opsionin nuk e dua më. Pjesë tjetër e rëndësishme mendoj janë tryezat e rrumbullakta, tryezat e diskutimeve unë edhe sot po them që dëgjova mjaftueshëm edhe e kuptova që është e nevojshme, jo vetëm si përfaqësues të operatorëve këtu në MSG ose përfaqësues të shoqërisë civile në MSG por si ti mbledhim dhe si ti kuptojmë, shoqërinë civile me cilë pjesë duhet ta lidhim, operatorin me cilën palë tjetër të interesit duhet ta lidhim dhe si të ngrejmë një diskutim i cili duhet të ketë pikë kulmore gjatë 2017 dhe një konferencë shtypi të madhe përse i përket industrisë nxjerrëse. Ma do mendja që ka vite që nuk bëhet?

Znj. Çinari: 2014 ka qënë e fundit “National”.

Znj. Zaimi: Konferencë Kombëtare?

Znj. Çinari: Po.

Znj. Zaimi: Ndoshta kjo mund të jetë pak më e zgjeruar rajonale ose ndërkombëtare që mund të sjelli një ekspertizë të mirëfilltë.

Znj. Çinari: Për çështje më konkrete, jo në përgjithësi.

Znj. Zaimi: Për çështje më konkrete, përshembull, edhe tryezat mendoj që do jenë tryeza që do dalin me sygjerime konkrete që mund të prekin interesin e operatorit, që mund të prekin interesin e shoqërisë civile, që mund të jenë konkluzione që mund të çojnë në nisma të tjera ligjore etj. Për parantezë, unë e kam babain inxhinier-gjeolog, jam e lindur dhe rritur në Bulqizë. Domethënë, unë e mbaj mend diskutimin për burimet natyrore në një nivel krejt tjetër por sot nuk shikoj një diskutim përveç një grupi të ngushtë njerëzish.

Z. Spahiu: Edhe ngaqë sektori hidrokarbur është privatizuar sot dhe dikur që ka qënë shtet ka qënë më ndryshe dhe kishte debat. Tani forca e tregut është private por jam dakort që duhen bërë konferenca, se duhen bërë disa dhe më shumë konferenca promovimi siç ishte Samiti i Naftës dhe Gazit që ishte shumë i rëndësishëm.

Znj. Zaimi: Ai ishte më tepër për thithjen e investitorëve.

Z. Spahiu: Një pyetje kisha unë, bën konferenca rajonale EITI?

Znj. Çinari: Në rajon anëtare është vetëm Shqipëria dhe është dhe Kosova duke u përpjekur të filloj.

Z. Spahiu: Pse mos ta zhvillojmë një ?

Znj. Çinari: E kemi një objektiv në planin e komunikimit një Konferencë Ndërkombëtare. Nuk kemi thënë rajonale por kemi thënë ndërkombëtare për qeverisjen e “Natural Resources Governance”. Thelbi i EITI-t është qeverisja e mirë e burimeve natyrore dhe ne nuk kemi pse t’ja vendosim emrin EITI se sa t’ja vendosim se si po qeveriset ky sektor, kush është strategjia dhe ka diskutime që mund ti bëj Sokoli, Përparimi pasi janë ekspertë.

Z. Spahiu: Ta bëjmë si në Lima.

Znj. Çinari: Ajo ishte mbledhje e Bordit dhe kjo MSG ka mundësi ta organizoj një mbledhje Bordi këtu në Shqipëri, pasi do ishte fenomenale.

Z. Spahiu: Ta bëj Sekretariati propozimim dhe le ta shqyrtoj Bordi.

Znj. Çinari: Ja po e them unë erdhi propozimi dhe publiciteti që bën ky aktivitet është shumë i madh.

Z. Mati: Të gjitha takimet janë bërë nëpër vende si Katari, Amerika.

Znj. Zaimi: Duhet parë edhe si një aktivitet që promovon.

Z. Mati: Ajo është gjë tjetër.

Znj. Çinari: Ai është qëllimi.

Z. Mati: Ne të orkanizojmë një konferencë kombëtare këtu, që të marrim vesh milet këtu. Ne nuk na dinë këta këtu.

Znj. Zaimi: Unë e kam që të shikohet çfarë na sillte më përpara kjo industri dhe çfarë na sjell sot?

Z. Mati: Bëjeni kombëtare se nuk na dinë këta këtu. Shkoni në Librazhd dhe pyetini.

Znj. Çinari: U lodhëm duke i pyetur dhe prap nuk na njohin.

Znj. Zaimi: Ata nuk dinë jo vetëm për EITI-n por edhe për operatorin që është aty.

Znj. Çinari: Në 2017 e kemi në plan, një Konferencë të madhe por për qeverisjen aparente të burimeve natyrore se për të thënë EITI gjithmonë, EITI dihet çfarë është por për të sjellë ekspert se kush është karakteristika e sektorit çfarë mund të bëhet më mire, pra të diskutohet teknikisht se nuk ka nevojë të bëhet politik çdo herë. Mendimi im.

Z. Neza: Dorina ne e kemi lexuar Strategjinë.

Znj. Çinari: Keni ndonjë koment Sami?

Z. Neza: E para ju keni parashikuar një aktivitet me pushtetin lokal mesa pashë aty dhe mund të bëhet më shumë se sa një aktivitet në këtë rast dhe mendoj se është më e dobishme kjo. E dyta ka patur një klub gazetarësh EITI i cili është themeluar në 2012. Unë besoj se ju i keni ato të dhënat dhe të ribëhet se është një klub i cili është trajnuar për këtë gjë me një ose dy seanca. E

treta ke një vend aty ku thua të blesh kronika televizive ajo duhet hequr sepse kronikat televizive nuk blihen dhe është e paligjshme

Znj. Zaimi: Fatkeqësisht blihen.

Z. Neza: E di blihen në të zeze por një institucion si EITI nuk duhet ta bëj.

Znj. Çinari: Jo ne nuk e bëjmë blerjen e bën agjencia e komunikimit.

Z. Neza: Edhe agjencia e komunikimit, të blesh hapsirë televizive, jo!

Z. Mati: Samiu me llogjik ka të drejtë.

Z. Neza: Shmangeni nga dokumenti sepse ne do ta aprovojmë dhe me atë unë nuk e votoj, shkel një ligj, ligjin e AMËS.

Znj. Çinari: Duhet formuluar ndryshe atëhere. Kemi luftuar me Top Channel për një emision një natë në talk show dhe nuk ja dolëm dot edhe me para.

Z. Neza: Një segment në “talk show” mund ta marrë se unë kam bërë projekte dhe e kam marrë segmentin në talk show por gjithë emisionin është e pamundur se i ul audience.

Znj. Çinari: Kaq kërkuam dhe ne segmentin.

Z. Alikaj: Mua më pëlqen ideja e studentëve sepse që aty fillon nëse do ti marrim gjërat drejtë si puna e shkenctarit që nuk i ikin kurrë nga truri ato që ka, pa vdekur. Dhe është shumë gjë e mirë ta fillojmë nga student dhe mandje edhe me nxënësit e shkollave në zonat që janë minerare ose të naftës sepse që aty fillon interesi. Tani këto që ke thënë janë interesante edhe ka një defekt në faqen 22 periudha fund nëntori deri në mes dhjetorit 2015, duhet 2017.

Znj. Zaimi: Është lapsus.

Znj. Çinari: Tjetër?

Z. Spahiu: Konferenca, newsletter ishte interesante.

Znj. Çinari: Ema ka propozuar një listë interesante aktiviteteve. A do kemi buxhet për ti mbuluar të gjitha? Megjithatë duke patur një plan pune kemi dhe ne mundësinë të kërkojmë

finacime, se thua kemi parashikuar këtë aktivitet dhe nuk e mbuloj dot. Kur s'ke ide nuk ke edhe çfarë kërkon.

Z. Alikaj: Unë shtoj të ketë donacione nga kompanitë që operojnë.

Znj. Çinari: Mund ta shëtisim këtë listë aktivitetsh dhe kush do të thotë unë kam dëshirë të financoj këtë aktivitet, është kjo e mundur?

Znj. Zaimi: Unë kam programuar fushata co-branding, pra me logot e përbashkëta të EITI-it dhe të kompanisë.

Znj. Çinari: Shumë faleminderit, keni qënë të gjithë shumë konstruktiv!

Tiranë më 31. 10. 2016